



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1102/Prot
3

Tiranë, më 14.11.2016

VENDIM

Nr. 73, datë 14.11.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Hotel "Aragosta"- Ray sh.p.k. Durrës, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhërit Nr. 220, datë 12.10.2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 17.10.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit, Hotel "Aragosta" - Ray sh.p.k. Durrës, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, masat për sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit, Hotel "Aragosta"- Ray sh.p.k. Durrës.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr. 220, datë 12.10.2016 të Komisionerit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi nuk e kishte kryer Njoftimin në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, por e përmbushi këtë detyrim në datë 20.10.2016.
2. Kontrolluesi aplikon mbikëqyrjen e ambienteve nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), dhe nuk ka vendosur tabela informuese, të cilat i vendosi në datë 20.10.2016.
3. Kontrolluesi nuk aplikon Deklaratë Konfidencialiteti me punëmarrësit.
4. Kontrolluesi nuk ka rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Kontrolluesi nuk aplikon politikat e privatësisë në portalin zyrtar: www.aragosta.al.

Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve dhe 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Në cilësinë e provës materiale, procesverbalit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formular Njoftimi i kontrolluesit Hotel “Aragosta” - Ray sh.p.k. Durrës.
- Fotografi të ambienteve.
- Ekstrakt i QKR-QKB.
- Printim nga portali www.aragosta.al.
- Listpagesa e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore, etj.

Në përmbyllje të procesit administrativ, u hartua dhe u lexua procesverbali në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit Hotel “Aragosta” - Ray sh.p.k. Durrës.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e kontrolluesit paraqitën pretendimin: “Nuk jemi dakort me pikat 5 dhe 6. pasi i kemi përmbushur pikat e pretenduara sipas ligjit.”

Vlen të theksohet se, Proces verbali i mbajtur në datë 20.10.2016 nuk përmban pikë të 6-të.

Zyra e Komisionerit, sjell në vëmendje të kontrolluesit Hotel “Aragosta” - Ray sh.p.k. Durrës:

1. Mungesa e një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, do të thotë mungesë masash paraprake, me qëllim shmangien e shkeljeve. Mungesa e rregullores dhe deklaratës së konfidencialitetit përbëjnë shkelje të parashikuara në Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, konkretisht në nenin 27 të tij, i penalizueshëm sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma “dh” i cili shprehet: “...kontrolluesit që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të përcaktuara në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë”.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, datë 30.04.2015, përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi Hotel “Aragosta” - Ray sh.p.k. Durrës, është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancë dëgjimore që do zhvillohej në datë 10.11.2016, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar. Përfaqësuesit e kontrolluesit nuk u paraqitën.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërmat “b”, “d” dhe “dh” të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, janë serioze dhe si të tilla, këto shkelje përbëjnë “kundërvajtje administrative”, të cilat sanksionohen me gjobë.

Kontrolluesi Hotel “Aragosta” - Ray sh.p.k. Durrës, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, kryesisht për kategorinë "klient".

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 39 pika 1, gërmat "d", "dh" si dhe nenit 39, pika 2 e Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit Hotel "Aragosta"- Ray sh.p.k. Durrës, me gjobë në vlerën **30.000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Kontrolluesi, Hotel "Aragosta" - Ray sh.p.k. Durrës, brenda një periudhe 10 (dhjetë) ditore nga dalja e këtij vendimi, të marrë masat për hartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe pajisjen e punëmarrësve me deklarata konfidencialiteti.
3. Kontrolluesi, Hotel "Aragosta" - Ray sh.p.k. Durrës, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masat për të përfshirë në faqen e tij të internetit rubrikën "Politikat e Privatësisë".
4. Kontrolluesi, Hotel "Aragosta"- Ray sh.p.k. Durrës, ka detyrimin të njoftojë Zyrën e Komisionerit, mbi përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ky akt.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 4.11.2016

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI